35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimit nga Menaxheri i Projektet dhe te jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit dhe të cilat kanë mbetur të parealizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimit. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

Shkelja e kontratës dhe shkëputja

Neni 36 Shkelja e kontratës

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

a) dëmet; dhe/ose

b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

a) dëme të përgjithshme; ose

b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

Neni37 Shkëputja e kontratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

a. Kontraktuesi ndërprenë punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonesës;
c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri I Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundoj vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më pare që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të siguroj vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 **"Force Madhore"** siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplodimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Ne rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësive të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.

ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.

iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritë nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.

iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.

v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit 39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshoj një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të

Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40 Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri I Projektit do të vërtetoj këtë. Kontraktuesi do të siguroj vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

a) ose vendim nga gjyqi;

b) kurdo qe palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin për mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

PJESA III E KONTRATES KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë [*shëno gjuhën e procedurës*].
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shuma e sigurisë së ekzekutimit është **10% e vlerës së kontratës, për një afat 4 mujor. (Prej fillimit deri në përfundim të punimeve dhe 30 ditë shtesë.)**
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Për humbje ose dëmtim të Punëve, Impianteve dhe Materialeve *[shëno shumat]*; (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve *[shëno shumat]*; (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën *[shëno shumat]*; (d) dëmtim personal ose vdekje: (i) të punëtorëve të Kontraktuesit: *[shëno shumat]* (ii) të personave të tjerë: *[shëno shumat]*
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda **(7 shtatë)** ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është *[shëno numrin]* ditë
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë **7 shtatë ditë pas nënshkrimit të kontratës**
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë ***(tre muaj)*** ditë kalendarike.
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë **0.05%** për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është **10%** e Çmimit final të Kontratës.
Regjistri i punës	20.1	[*Specifikoni nëse një regjistër i punës nuk nevojitet*]. **Nuk nevojitet një regjistër i punës, përveq atyre të përcaktuara me Ligjin e Ndërtimit.**

Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit është: **Sipas nenit 81 të LPP aktual në fuqi, Menagjimin e Kontratës nga ana e MPMS: Henrijeta Deva,** **Adem Iberhysaj nga kompania mbikqyrëse "Alb Architect", gjithashtu në menagjimin e kontratës do të jetë një përfaqsues i GIZ-it dhe Enhancing Youth Employment (EYE) Project.**
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: **PARAPAGIM (AVANS) NUK KA**
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: **10% e vlerës së punëve të kryera do të ndalet në afat 1 vjeçar pas pranimit teknik të punimeve dhe para lëshimit të pagesës përfundimtare do të depozitojë kontraktori në formë të garancionit bankar nga një bankë e klasit të parë.**
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë **7 shtatë** ditë pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve është ***365* ditë (1 vit).**
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është *[shëno përqindjen]*
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	*[Specifikoni departamentin e Komisionit përgjegjës për pajtim]*
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	*[shëno te dyja]* a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet *[specifikoni gjykatën kompetente]* në pajtim me ligjin në Kosovë. ose b) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të [specifiko organin për zgjedhjen e mosmarrëveshjes] në pajtim me *[specifiko rregullat e arbitrazhit (rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Tregtisë Ndërkombëtare, apo procedura të tjera të arbitrazhit të njohura ndërkombëtarisht)]*.

PJESA IV E KONTRATËS: **MODEL I SIGURISË SË EKZEKUTIMIT**

[Me logon e institucionit financiar që e jep sigurinë]

Për: Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
(në vazhdim: "autoriteti kontraktues"

Në emër të: [*emri dhe adresa e operatorit ekonomik*]
(në vazhdim "operatori ekonomik")

Titulli i aktivitetit të prokurimit: Ndërtimi i Zyres së Punësimit në Rahovec

Numri i Prokurimit: 209/16/012/521

Garancion me kërkesë te pare

DERISA operatori ekonomik i lartcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar Dosjes së Tenderit , me numër të prokurimit të lartcekur të dërguar nga Autoriteti Kontraktues;

DHE NGASE operatori ekonomik dëshiron të depozitojë sigurinë në shumën e saktësuar në Dosjen e tenderit;

DHE NGASE ne jemi pajtuar t`i japim operatorit ekonomik këtë siguri:

ANDAJ NE të poshtë nënshkruarit, me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një total prej: < *shuma e sigurisë me fjalë dhe shifra* > zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mos përmbushja e njërit nga kushtet në vijim:

a) Autoriteti kontraktues ka konstatuar në bazë të dëshmive të vërtetueshme objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substancionale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë; dhe
b) Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbet pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe /ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej: <shuma e garantuar> siç është lartcekur, do të bëhet pa asnjë kundërshtim as ankesë, sa më shpejtë që është e mundur pas regjistrimit të kërkesës suaj me konfirmimin "e pranimit".

Kjo siguri vlen deri me: <*data dhe koha*>

Nënshkrimi dhe vula e Garantuesve

_____

Emrili institucionit financiar

_____

Adresa

_____

Data

PJESA V E KONTRATËS: **IDENTIFIKIMI FINANCIAR**

MBAJTËSI I LLOGARISË	
Emri	
Adresa	
Qyteti	
Kodi Postar	
Kontakti	
Telefoni	
Fax	
E-mail	
Numri i TVSH	

BANKA	
Emri	
Adresa	
Qyteti	
Kod Postar	
Shteti	
Llogaria Bankare	
IBAN (opionale)	
BIC (Opcionale)	

SHËNIME:

VULA E BANKËS + NËNSHKRIMI I PËRFAQËSUESIT TË BANKËS (Të dyja të obligueshme)	DATA + NËNSHKRIMI I MBAJTËSIT TË LLOGARISË: (e obligueshme)

ANEKS 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

1. Përshkruaj specifikimet teknike, në mënyrë jo diskriminuese, karakteristikat e detyrueshme te objektit te kontratës siç janë: Kualiteti, sigurimi i kualitetit, performanca, terminologjia, kërkesat e dizajnit, simbolet, dimensionet, testimi dhe metodat e testimit, sigurimi, paketimi, shënjimi, etiketimi.

Specifikimet teknike duhet të përpilohen në mënyrë që të përputhen me qëllimin e prokurimit dhe të ofrojnë qasje sa më të madhe te operatorët ekonomik të interesuar.

Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar te vendosë specifikim teknik qe favorizojnë ose dis-favorizojnë një ose me shume operatorë ekonomik.

1. **Të respektohen të gjitha normat, standardet teknike ndërtimore**
2. **Të respektohet plotësisht Ligji i Ndërtimit**
3. **Të zbatohet përshkrimi teknik, gjegjësisht projekti kryesor (zbatues)**

ANEKSI 2 DEKLARATA NËN BETIM

Unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar: NPN EUROING deklaroj nën betim se jam i përshtatshëm në përputhje me Nenin 65, të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Kosovë, Ligji Nr. *04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.*

Unë vërtetoj se i kam lexuar kërkesat e përshtatshmërisë në Nenin 65 të LPP-së, respektivisht paragrafin 6 të Informacionit për Tenderuesit dhe vërtetoj se i përmbush kërkesat e përshtatshmërisë për pjesëmarrje ne këtë procedure te prokurimit.

Unë pranoj mundësinë e sanksionimeve penale dhe civile, gjobave dhe dënimeve, nëse unë për shkak të pakujdesisë dorëzoj çfarëdo dokumenti ose deklarata që përmban informata përmbajtësish të gabueshme ose mashtruese.

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emrili OE:	NPN "EUROING"
Adresa e plotë:	RRUGA "XHELAL HAJDA-TONI" P.N - RAHOVEC
I përfaqësuar nga:	
Emri:	KUJTIM
Pozita:	THAQI
Nënshkrimi:	
Data:	04.07.2016
Vula:	

PJESA C: FORMULAR PËR DORËZIMIN E TENDERIT

PJESA I. FORMULARI I TENDERIT

Për: Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
Rr."UÇK", nr.67, Prishtinë

(në vazhdim të tekstit "Autoriteti Kontraktues")

Titulli i kontratës: Ndërtimi i Zyres së Punësimit në Rahovec

Si përgjigje ndaj letrës suaj të ftesës për të tenderuar për kontratën e mësipërme, ne, të poshtë nënshkruarit, deklarojmë që:

1. I kemi kontrolluar dhe pranuar plotësisht përmbajtjet e dosjes së tenderit me Numër të Prokurimit: **<209/16/012/521>**. Ne pranojmë dispozitat e saj në tërësi, pa rezervim ose kufizim.

2. Ne ofrojmë të dorëzojmë, në pajtim me kushtet e dosjes së tenderit dhe afatet kohore të paraqitura, pa rezervë apo kufizim: Ndërtimi i Zyres së Punësimit në Rahovec

3. Çmimi total i tenderit është:

Çmimi i tenderit në shifra: [118,693.30€]

Dhe në fjalë [Njëqind e tetëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e tre Euro e tridhjetë Cent]

4. Ky tender është valid për një periudhë prej **60** ditëve nga data finale për dorëzim të tenderëve.

5. [Nëse tenderi jonë pranohet, ne marrim përsipër të sigurojmë një siguri të ekzekutimit para nënshkrimit të kontratës **[10% e vlerës së kontratës]**.

6. Operatori Ekonomik [*dhe nënkontraktuesit tonë*] kanë këtë nacionalitet: **[Kosovar]**

7. Ne e bëjmë këtë kërkesë, për këtë tender [*shëno numrin e Pjesës, nëse aplikohet*] me të drejtën tonë të udhëhequr nga ne. Ne konfirmojmë që nuk jemi duke tenderuar për të njëjtën kontratë me ndonjë formular tjetër.

[*Në rast të konsorciumit*]

[Ne e bëjmë këtë kërkesë, për këtë tender [*shëno numrin e Pjesës, nëse aplikohet*] **si partner në konsorcium** të udhëhequr nga [*shëno emrin e udhëheqësit*]. Ne konfirmojmë që nuk jemi duke tenderuar për të njëjtën kontratë me ndonjë formular tjetër. Konfirmojmë, si partner në konsorcium, se të gjithë partnerët, bashkërisht dhe veç e veç, janë të detyruar me ligj për realizim të kontratës; se partneri kryesor është i autorizuar të obligojë dhe të marrë udhëzime për secilin anëtar dhe në emër të secilit anëtar që realizimi i kontratës, duke përfshirë edhe pagesat, është përgjegjësia e partnerit kryesor, dhe se të gjithë partnerët në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium janë të obliguar të mbeten në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium gjatë tërë periudhës së realizimit të kontratës].

8. Ne do ta informojmë Autoritetin kontraktues menjëherë nëse ka ndonjë ndryshim në rrethanat e mësipërme në cilëndo fazë gjatë implementimit të kontratës. Gjithashtu ne e dimë dhe pranojmë që të gjitha informatat e paraqitura ose jo të plota të cilat jepen me qëllim në këtë

konkurrim, mund të kenë si rezultat përjashtimin tonë nga kjo dhe nga kontratat tjera të financuara nga BKK.

9. Theksojmë që Autoriteti kontraktues nuk është i obligjuar të vazhdojë me këtë ftesë dhe që e rezervon të drejtën për të dhënë vetëm një pjesë të kontratës. Ai nuk do të shkaktojë detyrime ndaj nesh nëse e bën këtë.

E DORËZUAR NGA

IDENTIFIKIM I OPERATORIT EKONOMIK	
EMRI I KOMPANISË[4]	NPN "EUROING"
ADRESA E PLOTË	RRUGA "XHELAL HAJDA – TONI" P.N - RAHOVEC
PËRFAQËSUAR NGA:	
EMRI & MBIEMRI	KUJTIM THAQI
POZITA	DREJTOR
NËNSHKRIM	
DATA	04.07.2016
VULA	

[Në rast Grupi Operatoresh ekonomik:]

	Emri (emrat)	Vend-sella
Partneri 1*	/	/
Etj ...*	/	/

** shtoni/fshini rreshta plotësues për partnerët sipas nevojës. Vini re që nënkontraktuesi nuk konsiderohet si partner për qëllime të kësaj procedure të tenderit.*

Emri dhe mbiemri i personit të autorizuar për të nënshkruar këtë tender në emër të Konsorciumit: [shëno emrin dhe mbiemrin]

Nënshkrimi: [nënshkrimi i personit të autorizuar]

Vendi dhe data: [shëno vendin dhe datën]

Vula e Udhëheqësit: _____

[4] Ne rast te Grupit te OE emri i liderit te Grupit te OE

PJESA II. PARAMASA DHE PARALLOGARIA

PËRMBLEDHJE:

PJESA	PËRSHKRIMI	TOTALI - €
	Ndërtimi i Zyres së Punësimit në Rahovec	
Totali i përgjithshëm:		**118,693.30€**

IDENTIFIKIM I OPERATORIT EKONOMIK (OE)	
EMRI I OE:	**NPN "EUROING"**
EMRI DHE MBIEMRI I PERFAQËSUESIT TE OE:	**KUJTIM THAQI**
NËNSHKRIMI:	
DATA:	**04.07.2016**
VULA:	

"IIBB CONSULTING"

PARAMASA E PUNËVE NDËRTIMORE PËR OBJEKTIN ' ZYRE KOMUNALE E PUNËSIMIT '- ZKP - RAHOVEC

Vërejtje: Çmimi për çdo pozicion duhët të përfshijë: Blerjën, furnizimin,transportin, punimin dhe montimin, lidhjet dhe sjelljen e pozicionit ne gjendje plotësisht funksionale, garancionin si dhe kompletimin e certifikatave dhe atesteve te prodhuesëve. Në çmim duhet të kalkulohet gjithashtu i terë materiali shpenzues deri në lëshuarjen në funksion.

Nr.	PËRSHKRIMI I PUNIMEVE	Njësia	Sasia për ofertë	Çmimi njësi	Gjithsejt €
A1. PUNET PREGATITORE					
A1.1	Demolimi I objektit ekzistues (objekti perdhesë 80 m2)dhe transporti i inerteve deri ne deponin me te afert . Demolimi i mureve te jashtme rrethuese te lokacionit dhe transporti i inerteve deri ne deponin me te afert ,pastrimi i parceles dhe pergatitja e terenit per fillimin e ndertimit te objektit. Në ketë pozicion llogaritet edhe rrethimi i lokacionit si masë mbrojtëse gjatë ekzekutimit te punimeve dhe te gjitha veprimet paraprake per fillim te punimeve.	paush.	1.00	500.00	500.00
A1	**Gjithsejt punët pergatitore**				**500.00**
A2. PUNET TOKESORE					
A2.1	Germimi i dheut te kategorise VI dhe VII per nivelim te terenit duke u bazuar në gjendjen reale te terenit si dhe transporti i dheut deri ne deponin me te afert	m^3	200.00	0.80	160.00
A2.2	Germimi i dheut te kategorise VII per hapjen e themeleve (themeleve te objektit,shkalleve te jashtme dhe rampes pë hendikep)dhe transporti i dheut deri ne deponin me te afert te caktuar nga organet kompetente komunale dhe orggani mbikqyres.	m^3	100.00	0.80	80.00
A2.3	Furnizimi,transportimi,planifikimi,shtruarja dhe ngjeshja e zhavorit 0-31mm' me trashsi d=20-25 cm me precizitet ±2cm. nën themelet shiritore te objektit, themeleve te shkalleve te jashtme, themeleve te rampes dhe pllakes se rampes për hendikep.	m^3	30.00	5.00	150.00
A2.4	Furnizimi,transportimi,planifikimi,shtruarja dhe ngjeshja e materialit ranor per mbushje te cokulles se objektit,shkalleve te jashtme dhe rampes për hendikep, fraksione te ndryshme me trashsi çdo d=20-30 cm me precizitet ±2cm. nën pllaken e dyshemese deri ne koten e zhavorit.	m^3	100.00	5.00	500.00
A2.5	Furnizimi,transportimi,planifikimi,shtruarja dhe ngjeshja e zhavorit 0-31mm' me trashsi d=15-20 cm me precizitet ±2cm. nën pllaken e dyshemesë se objektit,shkalleve te jashtme dhe rampes për hendikep	m^3	40.00	5.00	200.00

A2.6	Kthimi i sasise se nevojshme te dheut per gjate perimetrit te objektit si dhe nivlizimi i tije.	m^3	50.00	1.00	50.00
A2.7	Furnizimi dhe shtrirja e zhavorit me fraksion 0/63mm me d=20cm per platon hyrese, trotuarin rreth objekti dhe parkingjet duke e ngjeshur deri ne ngjeshmerine Mv=60 Mpa. .	m^3	38.00	5.00	190.00
A2.8	Furnizimi,transportimi,planifikimi,shtruarja dhe ngjeshja e zhavorit 0-31mm' me trashsi d=15-20 cm me precizitet ±2cm.per platon hyrese dhe trotuarin rreth objekti dhe parkingjet duke e ngjeshur deri ne ngjeshmerine Mv=60 Mpa.	m^3	38.00	5.00	190.00
A2	**Gjithsejt punet tokësore**				**1520.00**
A3. PUNET E ARMATURES					
A3.1	Furnizimi,transporti,prerja,lakimi dhe montimi i armaturës ndertimore S400/500 me profile te projektuara sipas specifikimit dhe detajeve ne projekt.	kg	16000.00	0.65	10400.00
A3.2	Furnizimi,transporti,dhe montimi i rrjetave te armaturës konstruktive Q-524 me profile te projektuara sipas specifikimit dhe detajeve ne projekt.	kg	6500.00	0.50	3250.00
A3	**Gjithsejt punët e armaturës**				**13650.00**
A4. PUNET E BETONIT					
A4.1	Furnizimi, transporti dhe betonimi themeleve shiritor dhe trajeve mbi themele te objektit,shkalleve te jashtme me beton sipas projektit me te gjitha punimet paraprake. Klasa e betonit C25/30 .	m^3	45.00	65.00	2925.00
A4.2	Furnizimi, transporti dhe betonimi soklles mbi themelet shiritore te objektit,shkalleve te jashtme me beton sipas projektit me te gjitha punimet paraprake. Klasa e betonit C25/30	m^3	30.00	65.00	1950.00
A4.3	Furnizimi, transporti dhe betonimi I pllakes mbi sokull (pllakes se dyshemese) te objektit,shkalleve te jashtme me beton sipas projektit me te gjitha punimet paraprake.Klasa e betonit C25/30	m^3	26.00	65.00	1690.00
A4.4	Furnizimi transportimi, pregatitja dhe betonimi i shkalleve te jashtme në hyrje te objektit dhe hyrje ekonomike me beton me te gjitha punimet paraprake. Klase e betonit (C25/30)	m^3	3.50	65.00	227.50
A4.5	Furnizimi transportimi, pregatitja dhe betonimi i rampes dhe mureve te saja komplet me themele, me beton sipas projektit me te gjitha punimet paraprake. Klasa e betonit (C25/30)	m^3	4.70	65.00	305.50
A4.6	Furnizimi transportimi, pregatitja dhe betonimi i shtyllave me beton sipas projektit me te gjitha punimet paraprake.Klasa e betonit C30/37	m^3	10.00	65.00	650.00

A4.7	Furnizimi transportimi, pregatitja dhe betonimi i mbi dyerve, dritareve dhe detaleve te tranzeneve dekorative te dritareve në fasaden e jashtme me beton sipas projektit me te gjitha punimet paraprake. Klasa e betonit C25/30	m^3	2.40	65.00	156.00
A4.8	Furnizimi, transportimi pregatitja montimi dhe betonimi i pllakës se konstruksionit meskatesh duke perfshi edhe strehen me trashësi sipas llogarise statike me klase te betonit C30/37 me te gjitha punimet paraprake.	m^3	55.00	65.00	3575.00
A4.9	Furnizimi, transportimi pregatitja montimi dhe betonimi i murit te atikes per gjate perimetrit te kulmit me beton sipas projekti me te gjitha punimet paraprake.Klasa e betonit C25/30	m^3	15.00	65.00	975.00
A4.10	Furnizimi, transportimi dhe betonimi i ESTRIHUT me makine në pllaken e perdheses mbi sokull,dhe pllakes se kulmit me trashesi d=(5-6)cm Në qmim duhet te llogaritet edhe armimi i estrihut me rrjete rabic Ø 4 mm	m^2	180.00	6.00	1080.00
A4.11	Furnizimi, transportimi dhe betonimi i ESTRIHUT me makine në pllaken e kulmit me trashesi d=(5-6)cm Në qmim duhet te llogaritet edhe armimi i estrihut me rrjete rabic Ø 4 mm	m^2	260.00	6.00	1560.00
A4.12	Furnizimi dhe punimi i platos hyrese dhe trotuarit rrethues te objektit me blloqe te betonit me trashesi 80mm, te vendosur ne shtratin prej 60mm rere. Llogaritja per m2 te siperfaqes se blloqeve te vendosura.	m^2	110	8.00	880.00
A4.13	Furnizimi dhe punimi i parkingut me blloqe te betonit me trashesi 80mm, te vendosur ne shtratin prej 60mm rere. Llogaritja per m2 te siperfaqes se blloqeve te vendosura.		60	8.00	480.00
A4.14	Furnizimi dhe montimi i skajoreve nga betoni me dimensione 240x60x1000mm te vendosur ne baze nga betoni. Llogaria te behet ne meter gjatesi te vendosur.	m'	130	6.00	780.00
A4.15	Furnizimi, punimi i shtreses rrafshuese i dyshemesë së shkalleve hyrese dhe ato ekonomike si dhe rampen për hendikep. Në pozicion llogaritet edhe rrjeta e armatures Q-335.	m^2	25.00	10.00	250.00
A4	**Gjithsejt punët e betonit**				**17484.00**
A5. PUNET MURATIMIT - SUVATIMIT					
A5.1	Furnizimi, transportimi,dhe muratimi i mureve te perdheses me blloqe te argjiles "Giter V" d=25 cm te cialt duhet te muratohen me llaq vazhdues në perpjesë 1:2:6. Ne qmim duhet te llogaritet edhe serkllazhi prej betonarmes.	m^3	45.00	40.00	1800.00
A5.2	Furnizimi, transportimi,dhe muratimi i mureve te perdheses me blloqe te argjiles "Giter V" d=20cm te cialt duhet te muratohen me llaq vazhdues në perpjesë 1:2:6. Ne qmim duhet te llogaritet edhe serkllazhi prej betonarmes.	m^3	12.00	40.00	480.00

A5.3	Furnizimi,transportimi dhe muratimi i mureve te objektit me blloka (tulla) prej argjillit me trashsi d=12 cm me llaq vazhdues ne përpjesë 1:2:6. Në qmim duhet te llogaritet edhe serkllazhii nevojshem ne lartësi h=2.15m me të gjitha punet paraprake	m²	30.00	12.00	360.00
A5.4	Furnizimi,transportimi muratimi i oxhakut te nxemjes qendrore me diameter d=300mm' prej elementeve te shamotit, shtresa e termoizoluese dhe elementeve te gatshme nga betoni .Ne qmim duhet te llogariten elementet per kyqje, pastrim si dhe koka e oxhakut me te gjitha pjeset përcjellse	m'	5.80	45.00	261.00
A5.5	Furnizimi,transportimi muratimi dhe mbeshtjellja e oxhakut te nxemjes qendrore me tulla te fasades duke vendosur ne mes termoizolim d=3-5 cm. Muratimi bëhet me llaq vazhdues ne përpjese 1:3	m'	2.10	20.00	42.00
A5.6	Furnizimi dhe suvatimi i **plafonit** me llaq cimento+gëlqeror me përpjesë 1:2:6 në dy shtresa(shtresa e parë llaq vazhdues ndersa shtresa e dytë llaq gelqeror) me lyerje paraprake me kontakt beton dhe me qumësht çimentoje.Në çmimi llogariten edhe këndoret metalike që vendosen në kënde.	m²	180.00	5.00	900.00
A5.7	Furnizimi dhe suvatimi i **mureve** me llaq cimento+gëlqeror me përpjes 1:2:6 në dy shtresa(shtresa e parë llaq vazhdues ndersa shtresa e dytë llaq gelqeror) me lyerje të mëparshme me kontakt beton për siperfaqet e betonit dhe me qumësht cimentoje.Në çmim llogariten edhe llajsenet metalike që vendosen në kënde, .	m²	490.00	5.00	2450.00
A5.8	Furnizimi dhe suvaimi i mureve me te gjitha sipërfaqet ku do te vendoset keramika dhe ne korridore deri ne lartesi te dyerve me llaq te qimentos ne përpjese 1:3 në te dy shtresat me sperkatje te mëparshme me llaq te holluar qimentoje. Në çmim llogariten edhe llajsenet metalike që vendosen në kënde,	m²	80.00	5.00	400.00
A5	**Gjithsejt punët e muratimit dhe suvatimit**				**6693.00**
A6. PUNET E KULMIT					
A6.1	Furnizimi,transporti,punimi dhe montimi ii konstruksionit të kulmit , struktura mbajtëse 12x14cm; shtangimet 12x14cm; mahit 10x12cm; kontralistellat 3x5cm/70cm; listellat 5x7cm/50cm . Sipas spec. Teknik dhe projektit.Llogaria m2 për shtrirje horizontale	m²	260.00	12.00	3120.00
A6.2	Furnizimi,transporti,punimi dhe montimi i dërrasave me trashesi d=2.5 cm sipas projektit .Llogaria per siperfaqen e pjerret te kulmit.	m²	260.00	6.00	1560.00
A6.3	Furnizimi,transporti,punimi dhe montimi i folies difuzive sipas projektit	m²	270.00	0.80	216.00

A6.4	Furnizimi,transporti,punimi dhe montimi i mbuleses nga llamarina e valëzuar e plastifikuar trapzoide me trashësi d=0.55 mm dhe te gjitha pjesët tjera përcjellese te kulmit, sipas projektit	m²	270.00	8.00	2160.00
A6.5	Furnizimi,transporti,punimi dhe montimi i lugjeve me llamarin pa valëzime, e plastifikuar d=0.55mm, e profiluar sipas rrelevit të llamarinës së mbulesës dhe gjërësi 2x80cm, përfshi ankorimet dhe ngjitjet adekuate. Sipas spec. teknik.	m'	30.00	7.00	210.00
A6.6	Furnizimi,transporti,punimi dhe montimi llamarines së plastifikuar me d=0.55 mm.mbi murin e atikes horizentale me te gjitha elementet përcjellse sipas sp. Teknik	m'	82.00	7.00	574.00
A6.7	Punimi dhe montimi i elementit këndor te murit te kallkanit dhe kulmit nga llamarina e plastifikuar me trashësi d= 0.55 mm nga mbulesa e kulmit deri te mbulesa e atikes pergjatë perimetrit te mbrendshem te murit te atikes vazhdimi i elementit te realizohet me lidhje "falso" dhe shirit izolues/lidhës. Ne këtë pozicion te përfshihen elementet për shtangim dhe shpuza jo te depërtueshme nga uji për mbylljen e lugjeve te llamarinës ne vendet ku është e nevojshme. Llogaria ne m' te elementit te vendosur.	m'	82.00	5.00	410.00
A6.8	Punimi dhe montimi ujmbeledhesit (ollukut) horizontal. Ujmbledhesi te punohet nga llamarina e plastifikuar me trashesi d=0.55 mm dhe me gjersi te shiritt si ne projekt min. gs= 1600 mm, vazhdimi i ujmbledhsave te realizohet me "fallso" lidhje dhe shirit izolues/lidhes. Ne kete pozicion te perfshihen shtangimet e nevojshme. Llogaria ne m' te ujmbledhesit te vendosur.	m'	24.00	8.00	192.00
A6.9	Furnizimi,transporti,punimi dhe montimi i ujëmbledhsave per largimine ujtë nga kulmi ne ulluqet vertikale me te gjitha elementet përcjellse	copë	2	8.00	16.00
A6.10	Furnizimi,transporti,punimi dhe montimi i olluqeve vertikale me te gjitha elementet përcjellse prej llamarines së plastifikuar me d=0.55 mm të vendosur në fasadë. Olluqet kane forme rrethore me diameter 20 cm. Matja bëhet ne m' duke llogaruar si pozicion i perfunduar së bashku me berrylat dhe fontanat. Prodhuesi duhet te jete Lindab ose e ngjashme.	m'	10	8.00	80.00
A6.11	Furnizimi,transporti,punimi,montimi dhe mbështjellja e kanaleve te oxhaqeve me llamarine te plastifikuar . Oxhaku I nxemjes qendrore.	copë	1	35.00	35.00
A6.12	Furnizimi,transporti,punimi dhe montimi i kokes se oxhakut nga llamarina e zinguar sipas kerkeses se investitorit.	copë	1	25.00	25.00

A6.13	Furnizimi,transporti, dhe pregatitja dhe montimi I sollbankave të jashtme në dritare prej llamarinës së plastifikuar d=0.55 mm. Me sipërfaqe te zgjeruar sipas projekti	m'	20	6.00	120.00
A6	**Gjithsejt punët e llamarinës**				**8718.00**
A7. PUNET E IZOLIMIT					
A7.1	Furnizimi,transporti, punimi dhe vendosja e shtreses termoizoluese me materializim "stiropor" me trashsi t=3 cm (N4) ne dysheme e pllakes mbi sokull (jo ne toalete).Ne llogari te merret edhe folija plastike PVC ne pjesen e siperme.	m²	165	3.00	495.00
A7.2	Furnizimi,transporti, punimi dhe vendosja e shtreses termoizoluese me materializim "stirodur N4" me trashsi t=8 cm (N4) në pllaken e kulmit .Ne llogari te merret edhe folija difuzive ne pjesen e poshtme dhe PVC ne pjesen e siperme	m²	260.00	4.00	1040.00
A7.3	Furnizimi,transporti, punimi dhe vendosja e hidoizolimit horizental me nje lyerje te ftohte (bitulit) dhe dy shtresa hidroizolim Kondor me trashesi 4mm'. Ketu është perfshire edhe hidroizolimi nën mure.	m²	200	2.00	400.00
A7.4	Furnizimi dhe punimi I hidroizolimit te mureve te banjos ku vendoset keramika ne lartesine prej 1.8 m me material te lengët hidromal.Punimi te behet ne dy shtresa duke vendosur edhe rrjete plastike per te eleminuar palasaritjet eventuale nga trashesia e perdorur e materialit.	m²	40	4.00	160.00
A7	**Gjithsejt punët e izolimit**				**2095.00**
A8. PUNET E ZDRUKTHTARISE					
A8.1	Furnizimi,transportimi dhe montimi i dritareve prej PVC me profile gjermane "TROKAL,Aluplast,Rehau,Thyssen" ose te ngjajshme të paisur me xham termopan 4+12+4, komplet me mekanizmi përhapje dhe mbyllje dhe hapje "kiper".(zgjedhja e ngjyres behet nga investitori).Dim 100x100 sipas specifikacionit teknik	copë	6	75.00	450.00
A8.2	Furnizimi,transportimi dhe montimi i dritareve prej PVC me profile gjermane "TROKAL,Aluplast,Rehau,Thyssen" ose te ngjajshme të paisur me xham termopan 4+12+4, komplet me mekanizmi përhapje dhe mbyllje dhe hapje "kiper".(zgjedhja e ngjyres behet nga investitori).Dim 315x150 sipas specifikacionit teknik	copë	1	300.00	300.00

A8.3	Furnizimi,transportimi dhe montimi i Murit (dritare e mbrendshme) M1 prej xhami me profile prej Alumini trashesi te mureve te profilit t=1.5 mm dhe peshe specifike 1.8kg/m të paisur me xham termopan 4+12+4. dim 300x253 sipas specifikacionit teknik	copë	2	493.00	986.00
A8.4	Furnizimi,transportimi dhe montimi i Murit (dritare e mbrendshme) M2 prej xhami me profile prej Alumini trashesi te mureve te profilit t=1.5 mm dhe peshe specifike 1.8kg/m të paisur me xham termopan 4+12+4. dim 300x305 sipas specifikacionit teknik	copë	1	540.00	540.00
A8.5	Furnizimi,transportimi dhe montimi i Murit (dritare e mbrendshme) M3 prej xhami me profile prej Alumini trashesi te mureve te profilit t=1.5 mm dhe peshe specifike 1.8kg/m të paisur me xham termopan 4+12+4. dim 300x305 sipas specifikacionit teknik	copë	1	540.00	540.00
A8.6	Furnizimi,transportimi dhe montimi i Murit (dritare e mbrendshme) M4 prej xhami me profile prej Alumini trashesi te mureve te profilit t=1.5 mm dhe peshe specifike 1.8kg/m të paisur me xham termopan 4+12+4. dim 300x385 sipas specifikacionit teknik	copë	1	690.00	690.00
A8.7	Furnizimi,transportimi dhe montimi i Murit (dritare e mbrendshme) M5 prej xhami me profile prej Alumini trashesi te mureve te profilit t=1.5 mm dhe peshe specifike 1.8kg/m të paisur me xham termopan 4+12+4. dim 300x89 sipas specifikacionit teknik	copë	2	200.00	400.00
A8.8	Furnizimi,transportimi dhe montimi i Murit (dritare e mbrendshme) M6 prej xhami me profile prej Alumini trashesi te mureve te profilit t=1.5 mm dhe peshe specifike 1.8kg/m të paisur me xham termopan 4+12+4. dim 300x300 sipas specifikacionit teknik	copë	1	540.00	540.00
A8.9	Furnizimi,transportimi dhe montimi i Murit (dritare e mbrendshme) M7 Sportel me perpunim druri i perpunuar dhe pjesa emerme prej xhami me profile prej Alumini trashesi te mureve te profilit t=1.5 mm dhe peshe specifike 1.8kg/m të paisur me xham termopan 8mm . dim 300x360 sipas specifikacionit teknik	copë	1	700.00	700.00

A8.10	Furnizimi dhe montimi i Fasades Gjysem-Strukturale sipas ISO ose DIN Standardeve me dimensione dhe hapje(në çmim llogariten edhe hapjet-20 hapje,me korniz dhe mekanizem te veçant) si ne skemë, te prodhuesit ALUMIL apo prodhues tjeter me kualitet te njejet . Qelqi i fasades eshte qelq i kalitur me ngyre 6+16+6 mm me koficient termik UG= 1.7 W/m2K. Llogarimi ne m² te siperfaqes se vendosur.	m²	76	70.00	5320.00
A8.11	Furnizimi,transportimi dhe montimi I dyerve prej Alumini , trashesi te mureve te profilit t=1.5 mm dhe peshe specifike 1.8kg/m. Sperfaqet te plotesohen me qelq termoizolues d=4+12+4 mm te kualitetit larte,llojit FLOAT, panele te Al kompatibil me profilet. Dim 90/210 (D3) me pershtatje sipas mureve(dritareve) te mbrendshme prej xhami. Të gjitha dyert janë te paisur me mekanizem përkates për hapje, mbyllje sipas sp. teknik	copë	1	200.00	200.00
A8.12	Furnizimi,transportimi dhe montimi I dyerve prej Alumini , trashesi te mureve te profilit t=1.5 mm dhe peshe specifike 1.8kg/m. Sperfaqet te plotesohen me qelq termoizolues d=4+12+4 mm te kualitetit larte,llojit FLOAT, panele te Al kompatibil me profilet. Dim 115/210 (D4)me pershtatje sipas mureve(dritareve) te mbrendshme prej xhami. Të gjitha dyert janë te paisur me mekanizem përkates për hapje, mbyllje sipas sp. teknik	copë	1	210.00	210.00
A8.13	Furnizimi,transportimi dhe montimi I dyerve prej PVC me profile gjermane "TROKAL,Aluplast,Rehau,Thyssen" ose te ngjajshme të paisur me mbushje ne mes te profileve behet me termopanel prej plastikës dhe pjesa e eperme me mbindriçim me xham te patejdukshem. Të gjitha dyert janë te paisur me mekanizem përkates për hapje, mbyllje.Dim.75/260 (D10) sipas sp. teknik	copë	2	150.00	300.00
A8.14	Furnizimi,transportimi dhe montimi I dyerve prej PVC me profile gjermane "TROKAL,Aluplast,Rehau,Thyssen" ose te ngjajshme të paisur me mbushje ne mes te profileve behet me termopanel prej plastikës . Të gjitha dyert janë te paisur me mekanizem përkates për hapje, mbyllje.Dim.75/210 (D11) sipas sp. teknik	copë	2	150.00	300.00

A8.15	Furnizimi,transportimi dhe montimi I dyerve prej PVC me profile gjermane "TROKAL,Aluplast,Rehau,Thyssen" ose te ngjajshme të paisur me mbushje ne mes te profileve behet me termopanel prej plastikës dhe pjesa e eperme me mbindriçim me xham te patejdukshem. Të gjitha dyert janë te paisur me mekanizem përkates për hapje, mbyllje.Dim.100/260 (D7) sipas sp. teknik	copë	1	200.00	200.00
A8.16	Furnizimi,transportimi dhe montimi I dyerve prej druri me furnir ne te dy anet 4 mm dhe perqueshmeri zeri min. Rw=29 Db si dhe me mekanizem përkates për hapje dhe mbyllje. Dim.100/260 (D6) sipas sp. teknik	copë	1	300.00	300.00
A8.17	Furnizimi,transportimi dhe montimi I dyerve prej druri me furnir ne te dy anet 4 mm dhe perqueshmeri zeri min. Rw=29 Db si dhe me mekanizem përkates për hapje dhe mbyllje. Dim.90/210 (D5) sipas sp. Teknik	copë	1	200.00	200.00
A8.18	Furnizimi,transportimi dhe montimi I dyerve prej Alumini menderprerje termike, trashesi te mureve te profilit t=1.5 mm dhe peshe specifike 1.8kg/m (panel muri i qelqit me dyer te vendosura sipas skemes dhe sp. teknik). Të gjitha dyert janë te paisur me mekanizem përkates për hapje, mbyllje.Dyert te jene dy kriheshe dhe te cilat hapen ne 180 shkalle ne te dy anet jasht dhe brenda. Sperfaqet te plotesohen me qelq termoizolues d=4+12+4 mm te kualitetit larte,llojit FLOAT, panele te Al kompatibil me profilet. Dim 160/215 (D2) sipas skemes dhe sp. teknik	copë	1	250.00	250.00
A8.19	Furnizimi,transportimi dhe montimi I dyerve prej Alumini menderprerje termike, trashesi te mureve te profilit t=1.5 mm dhe peshe specifike 1.8kg/m (panel muri i qelqit me dyer te vendosura sipas skemes dhe sp. teknik). Të gjitha dyert janë te paisur me mekanizem përkates për hapje, mbyllje. Sperfaqet te plotesohen me qelq termoizolues d=4+12+4 mm te kualitetit larte,llojit FLOAT, panele te Al kompatibil me profilet. Dim 160/215 (D1) sipas skemes dhe sp. teknik	copë	1	260.00	260.00
A8.20	Furnizimi transporti dhe montimi i dyerve metalike ne hapësiren e kalldasë, dim:100 x 210 cm	copë	1	200.00	200.00
A8.21	Furnizimi,transportimi dhe montimi i deres prej Alumini , trashesi te mureve te profilit t=1.5 mm dhe peshe specifike 1.8kg/m. Dim 100/210 (D9) sipas sp. teknik		1	200.00	200.00

A8.22	Furnizimi,montimi i perdeve veneciane me fletëza alumini për te gjitha dritaret dhe muret nga xhami i objektit	m²	140	15.00	2100.00
